



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-22660 /2017
Kaçanik, 12.07.2017

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit, 01.Nr.400-2155/1, të datës 27.01.2017 si dhe Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, bënë:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SUBVENCION
Në fushën e Kulturës, për botimin Monografia e Gjimnazit
“Skënderbeu” Kaçanik në vlerë prej 4.000 €.

Përkrahja financiare për hartimin dhe botimin e Monografisë së Gjimnazit “Skënderbeu” në Kaçanik do t’i jepet subjektit i cili do ti plotësojë këto kushte dhe kriteret:

1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Gjimnazit “Skënderbeu” dhe personelin arsimor, të sigurojë informatat e nevojshme dhe materialet fosile arkivore;
2. Të përpunojë profesionalisht dhe me saktësi shkencore të dhënat për botim (si radhitja, seleksionimi, mbikëqyrja e procesit, finalizimi i tekstit etj.);
3. Të angazhojë redaktorët, lektorin, korrektorin për rregullimin stilistik e gjuhësor standard të tekstit;
4. Përmes profesionistëve të fushës përkatëse të faqos materialin, të dizajnoj dhe punoj kopertinat, njëkohësisht renditjes dhe dizajnimit të fotografive brenda projektit;
5. Shtypi i librit monografik të bëhet me cilësi të lartë të letrës, 90-110 gramë, në format B5, në teknikën bardhë e zi, me kopertinë 350 gramësh të plastifikuar;
6. Në përputhje me materialin e përpunuar, pa u cenuar cilësia, libri të ketë vëllim rreth 400-450 faqe, formati B5 (17cm x 24 cm), ndërsa për shkak të fotografive shtypi të jetë i avancuar dhe letra profesionale;
7. Tirazhi, 1000 kopje.

Subjekti, përfitues i këtij projekti duhet që aplikacionit t’ia bashkangjesë edhe dokumentet e kërkuara sipas Rregullores së lartpërmendur:

- Projekt propozimin;
- Certifikatën e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikatën e numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetimin e regjistrimit pranë Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në Kaçanik;
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit /që përfaqëson organizatën;
- Xhirologarinë dhe dëshminë e bankës në emër të organizatës;
- Dëshminë se nuk ka obligime organizata ndaj ATK;
- Dëshminë për pagesën e taksave komunale.

Kërkesa për aplikim duhet të përmban:

- Qëllimin e kërkesës/projektit;
- Projekt Propozimi bashkë me koston totale dhe kosto që kërkohet nga Komuna;
- Formulari për aplikim.

Data e aplikimit është nga 12.07.2017 deri 26.07.2017.

Formulari i aplikacioneve merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Qendrën për shërbim me qytetar **-Zyra e pranimit** (sporteli nr. 5 nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.)

Vërejtje:

- *Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohet;*
- *Konkuruesit të cilët nuk kanë përmbyllur avanset e mëparshme ndaj këtij institucioni, nuk do të merren në shqyrtim;*
- *Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen.*



Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi